

# 5 Kodi i Sjelljes për Kryqin e Kuq Ndërkombëtar dhe Lëvizjen e Gjysmë-Hënës së Kuqe dhe OJQ-të në Lehtësimin ndaj Fatkeqësisë

I përgatitur nga Federata ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Shoqëritë e Gjysmë-Hënës së Kuqe si edhe të ICRC-së.

## Qëllimi

Kodi i Sjelljes kërkon të mbrojë Standardet tona të sjelljes. Ai nuk është për detaje operative, si për shembull si duhet të llogarisë racionet e ushqimit apo si duhet të ngrihet një kamp refugjatësh. Akoma më tepër, ai kërkon të ruajë Standardet e larta të pavarësisë, efektivitetit dhe ndikimit ndaj fatkeqësisë mbi të cilat synojnë të përgjigjen në fatkeqësi OJQ-të dhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar dhe Lëvizja Gjysmë-Hëna e Kuqe. Ky është një kod vullnetar, i diktuar nga vullneti i organizatave për ta pranuar atë për të ruajtur Standardet e parashtruara në kod.

Në rastin e një konflikti të armatosur, Kodi aktual i Sjelljes do të interpretohet dhe do të zbatohet në lidhje me ligjin ndërkombëtar humanitar.

## Shenime

1. Sponsorizuar nga: Caritas International\*, Catholic Relief Services\*, The International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies\*, International Save the Children Alliance\*, Lutheran World Federation\*, Oxfam\*, The World Council of Churches\*, The International Committee of Red Cross (\* anëtarët e Komitetit Drejtues në Përgjigjen Humanitare).

Kodi i Sjelljes paraqitet i pari. Bashkëngjitur me të janë 3 anekse, që përshkruajnë ambientin e punës që ne do të dëshirojmë të shihnim të krijuar nga qeveritë pritëse, Qeveritë Donatore dhe Organizatat Ndërkombëtare me qëllim që të lehtësohet shpërndarja efektive e ndihmës humanitare.

## Përfundimet

**OJQ-të:** OJQ-të (Organizatat Jo-Qeveritare) u referohen këtu organizatave si ato Kombëtare ashtu edhe ato Ndërkombëtare, të cilat janë të ndara me ligj nga qeveria e vendit në të cilin ato janë formuar.

**AHQ-të:** Për qëllime të këtij teksti, termi Agjencitë Humanitare Jo-Qeveritare (AHQ-re) është vendosur për të përfshirë komponentët e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe të Lëvizjes Gjysmë-Hëna e Kuqe, Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq, Shoqëritë Gjysmë-Hëna e Kuqe dhe shoqëritë Kombëtare anëtare të saj- dhe OJQ-të siç janë përshkruar më lart. Ky kod u referohet kryesisht AHQ-ve të cilat janë të përfshirë në përgjigjen ndaj fatkeqësisë.

**ONQ-të:** ONQ-të (Organizata Ndërqeveritare) u referohet organizatave të drejtuara nga dy ose më shumë qeveri. Ky term kështu përfshin të gjitha agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe Organizatat Rajonale.

**Fatkeqësitë:** një fatkeqësi është një ngjarje e tmerrshme që shkakton humbje të jetës, vuajtje të mëdha njerëzore dhe stres, fatkeqësi si edhe dëme materiale të një shkalle të gjerë.

## Kodi i Sjelljes

### Parimet e Sjelljes për Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, Lëvizjen Gjysmë-Hëna e Kuqe dhe OJQ-të në Programet e Reagimit ndaj Fatkeqësisë

#### 1 Rëndësia humanitare vjen e para

E drejta për të përfutur asistencë humanitare, dhe për ta ofruar atë, është një princip fundamental i humanizmit i cili duhet të pëlqehet nga të gjithë qytetarët e të gjithë vendeve. Si anëtarë të komunitetit ndërkombëtar, ne njohim detyrimin tonë për të siguruar ndihmë humanitare kurdo që është e nevojshme. Kështu nevoja për mundësi të pakufizuara hyrëse te popullatat e prekura është e një rëndësie themelore në ushtrimin e kësaj përgjegjësie. Motivimi i parë i reagimit tonë ndaj fatkeqësisë është që të zbusim vuajtjet njerëzore midis atyre që janë më pak të aftë të përballojnë stresin e shkaktuar nga fatkeqësia. Kur ne japin ndihmë humanitare, ky nuk është një akt politik apo partiak dhe nuk duhet të shihet si i tillë.

#### 2 Ndihma jepet pavarësisht nga raca, besimi apo kombësia e njerëzve që e kërkojnë atë edhe pa asnjë dallim ndërmjet tyre. Prioritetet e ndihmës llogariten vetëm mbi bazën e nevojës së saj.

Kudo që të jetë e mundur, ne do të bazojmë sigurimin e ndihmës mbi një vlerësim të plotë të nevojave të viktimave të fatkeqësisë edhe kapaciteteve lokale që ekzistojnë për të plotësuar këto nevoja.

Brenda të gjitha programeve tona, ne do të reflektojmë konsideratat e proporcionalitetit (ndarjes përkatëse). Vuajtja njerëzore duhet të lehtësohet kudo që ajo të gjendet; jeta është po aq e vlefshme në një pjesë të vendit sa edhe në pjesë të tjera të tij. Kështu, kushti ynë i ndihmës do të reflektojë shkallën e vuajtjes që ai kërkon të lehtësojë.

Në implementimin e kësaj arritjeje, ne njohim rolin kryesor të luajtur nga gratë në komunitetet e kërcënuara nga fatkeqësisë dhe do të

garantojmë se ky rol mbështetet, dhe jo zvogëlohet nga programet tona të ndihmës.

Implementimi i një politike të tillë universale, jo të pjesëshme, dhe të pavarur, mund të jetë efektiv vetëm në qoftë se ne edhe partnerët tanë kemi mundësi të shfrytëzojmë burimet e nevojshme të siguruar për lehtësim të barabartë të dhimbjes, dhe kemi mundësi të barabartë ndaj të gjithë viktimave të fatkeqësisë.

#### 3 Ndihma nuk do të përdoret për të parashtruar pikëpamje të caktuara politike dhe fetare

Ndihma humanitare do të jepet sipas nevojës të individëve, familjeve dhe komuniteteve. Duke mos toleruar të drejtën e AHJQ për ekspozim të opinioneve të veçanta politike dhe fetare, ne pranojmë që ndihma nuk do të varet nga përfshirja e marrësve në opinione të ndryshme.

Ne nuk do të lidhim premimin për ndihmë, dhënien dhe shpërndarjen e saj me kushtin e përfshirjes ose pranimit të besimeve të veçanta politike dhe fetare.

#### 4 Ne do të përpiqemi të mos veprojmë si instrumentet e politikës së jashtme të qeverisë

AHJQ-të janë agjenci të cilat veprojnë në mënyrë të pavarur nga qeveritë. Prandaj ne formulojmë politikat dhe strategjitë tona të implementimit edhe nuk kërkojmë të zbatojmë politikën e ndonjë qeverie, me përjashtim të rasteve kur ato përputhen me politikat tona të pavarura.

Ne kurrë nuk do t'ia lejojmë vetes ose punonjësve tanë, në mënyrë të vetëdijshme ose nga neglizhenca, për të shërbyer si mbledhës të informacionit politik, ushtarak apo ekonomik për qeveritë apo organizmat e tjera, dhe as nuk do të veprojmë si instrumente të politikës së jashtme të qeverive donatore.

Ne do të përdorim ndihmën që marrim për t'iu përgjigjur nevojave dhe kjo ndihmë nuk duhet të drejtohet nga nevojat e donatorëve dhe

as nga interesat politike të ndonjë donatori të veçantë.

Ne vlerësojmë dhe përkrahim punën vullnetare të dhënë dhe financat e dhëna nga individë të veçantë për të mbështetur punën tonë, dhe njohim pavarësinë e veprimit të përkrahur nga një motivacion i tillë vullnetar. Me qëllim që të mbrojmë pavarësinë tonë ne do të kërkojmë të shmangim varësinë nga një burim i vetëm fondesh.

## **5 Ne do të respektojmë kulturën dhe traditat**

Ne do të përpiqemi të respektojmë kulturën, strukturat dhe traditat e komuniteteve dhe të vendeve për të cilat ne punojmë.

## **6 Ne do të përpiqemi të ngremë përgjigjen ndaj fatkeqësisë mbi bazën e kapaciteteve lokale**

Të gjithë njerëzit dhe komunitetet madje edhe në fatkeqësi kanë kapacitete si edhe mangësi. Atye ku është e mundur, ne do t'i forcojmë këto kapacitete duke punësuar personelin lokal, blerjen e mallrave lokale dhe tregtinë me kompanitë lokale. Atye ku të jetë e mundur, ne do të punojmë nëpërmjet AHJQ-ve lokale si partnerë në planifikimin dhe zbatimin e programeve, dhe do të bashkëpunojmë me strukturat qeveritare lokale aty ku do të shihet e arsyeshmë.

Ne do të vendosim një prioritet të lartë mbi koordinimin e duhur të reagimive tona të emergjencës. Kjo realizohet më mirë brenda vendeve të interesuara, nëpërmjet atyre që janë përfshirë direkt në aktivitetet e shpëtimit, dhe do të përfshijmë përfaqësuesit e vendeve përkatëse të Kombeve të Bashkuara.

## **7 Rrugët do të gjenden për të përfshirë përfituesit e programit në menaxhimin e ndihmës humanitare**

Asistenca në përgjigjen ndaj fatkeqësive kurrë nuk duhet t'u imponohet përfituesve. Ndihma efektive dhe një rehabilitim i qëndrueshëm mund të arrihet më mirë atëherë kur përfituesit e piketuar përfshihen në projektimin, menaxhimin dhe zbatimin e programit të asistencës. Ne do të përpiqemi shumë për të arritur pjesëmarrje të plotë të komunitetit

në programet tona të shpëtimit dhe rehabilitimit.

## **8 Ndihma për shpëtim duhet të përpiqet shumë për të ulur shkallën e prekshmërisë së pritshme nga fatkeqësia ashtu si edhe në plotësimin e nevojave bazë**

Të gjitha veprimet për shpëtim ndikojnë në perspektivat e zhvillimit afatgjatë, si në mënyrë pozitive ashtu dhe negative. Duke njohur këtë, ne do të përpiqemi shumë për të zbatuar programet e shpëtimit të cilat në mënyrë aktive pakësojnë prekshmërinë e "përfituesve"- ndaj një fatkeqësie tjetër në të ardhmen, dhe ndihmojnë në krijimin e një mënyrë jetese më të qëndrueshme. Ne do t'u kushtojmë një vëmendje të veçantë problemeve të ambientit në projektimin dhe drejtimin e programeve të shpëtimit. Ne gjithashtu do të përpiqemi për të minimizuar ndikimin negativ të ndihmës humanitare, duke kërkuar shmangien e varësisë afatgjatë të përfituesve ndaj ndihmës së jashtme.

## **9 Ne mbajmë përgjegjësinë tonë ndaj atyre që ne kërkojmë t'i ndihmojmë si edhe ndaj atyre nga të cilët ne pranojmë burime**

Ne shpesh veprojmë si një lidhje institucionale në partneritet midis atyre që dëshirojnë të ndihmojnë dhe atyre që kanë nevojë për ndihmë gjatë fatkeqësive. Për këtë arsye, ne mbajmë përgjegjësinë tonë në të dyja rastet.

Të gjitha veprimet tona me donatorët dhe me bamirësit do të reflektojnë qëndrimin tonë të hapur dhe transparencën.

Ne e njohim nevojën për të raportuar mbi aktivitetet tona, si nga pikëpamja financiare ashtu dhe nga pikëpamja e efektivitetit.

Ne e njohim detyrimin tonë për të garantuar monitorimin e duhur të shpërndarjes së ndihmës edhe për të kryer vlerësimet e rregullta mbi ndikimin e ndihmës ndaj fatkeqësisë.

Gjithashtu ne do të kërkojmë të raportojmë, në mënyrë të hapur, mbi ndikimin e punës tonë, dhe faktorëve që e kufizojnë ose e mundësojnë këtë ndikim.

Programet tona do të bazohen mbi Standardet e larta të profesionalizimit dhe ekspertizës me qëllim që të zvogëlojnë humbjen e burimeve me vlerë.

## **10 Në aktivitetet tona mbi informacionin, publikimin dhe reklamimin, ne do t'i njohim viktimat e fatkeqësisë si njerëz me dinjitet dhe jo si objekte të pashpresë**

Respekti për viktimat e fatkeqësisë, si partnerë të barabartë në veprim, nuk duhet të shuhet kurrë. Në informacionin tonë publik ne do të japim një imazh objektiv të situatës së fatkeqësisë ku theksohen qartë kapacitetet dhe aspiratat e viktimave, dhe jo vetëm frika dhe dobësitë e tyre.

Ndërkohë që ne do të bashkëpunojmë me median me qëllimin që të ngrejmë reagimin publik, ne nuk do të lejojmë që kërkesat e jashtme dhe të brendshme për publicitet të marrin përparësi mbi principet për maksimizimin e të gjithë ndihmës për shpëtim. Ne do të shmangim konkurrimin me agjencitë e tjera të përgjigjes ndaj fatkeqësisë, për mbulimin e medias në situatat kur ky mbulim mund të çojë në dëmtrim të shërbimit të siguruar për përfituesit ose në sigurimin e personelit tonë dhe të përfituesve.

## **Mjedisi i Punës**

Mbasi kemi pranuar që të përpiqemi për t'u mbështetur nga Kodi i përcaktuar më lart, ne paraqesim më poshtë disa udhëzime indikative të cilat përshkruajnë ambientin ku punohet që ne do të dëshironim të krijohej nga qeveritë donatore, qeveritë pritëse dhe organizatat ndërqeveritare - kryesisht agjencitë e Kombeve të Bashkuara - me qëllim që të mundësojnë pjesëmarrjen efektive të AHJQ-ve në reagimin ndaj fatkeqësisë.

Këto udhëzime janë paraqitur për mbrojtje. Ato nuk janë dhënë në formë legale, dhe as nuk presim që qeveritë dhe OJQ-të të ndikojnë aprovimin e tyre ndaj udhëzimeve nëpërmjet firmosjes së ndonjë dokumenti, megjithëse ky mund të jetë një qëllim për të punuar në të ardhmen. Ato janë paraqitur në mënyrë të hapur, kështu partnerët tanë do të bëhen të ndërgjegjshëm për marrëdhëniet ideale që ne do të kërkojmë të kemi me ta.

## **Aneksi I: Rekomandimet për qeveritë e vendeve të prekura nga fatkeqësia**

### **1 Qeveritë duhet të njohin dhe të respektojnë veprimet e pavarura, humanitare dhe të barabarta të AHJQ-ve**

AHJQ-të janë organizata të pavarura. Kjo pavarësi dhe paanshmëri do të respektohet nga qeveritë pritëse.

### **2 Qeveritë pritëse duhet të shpejtojnë mundësinë e shfrytëzimit të AHJQ-ve për viktimat e fatkeqësisë.**

Në qoftë se AHJQ-të veprojnë në lidhje të ngushtë me principet e tyre humanitare, ato duhet të ndihmohen shpejt dhe në mënyrë të barabartë gjatë shpërndarjes së ndihmës humanitare. Është detyra e qeverisë pritëse, që të mos bllokojë këtë ndihmë, edhe të pranojë veprimin e paanshëm dhe jo-politik të AHJQ-ve.

Qeveritë pritëse duhet të ndihmojnë hyrjen e shpejtë të grupit të shpëtimit, në veçanti duke hequr kërkesat për qëndrim tranzit, viza hyrëse dhe dalëse ose duke aranxhuar dhëmen e tyre.

Qeveritë duhet të garantojnë lejen e fluturimit dhe të drejtat e uljes së avionëve transportues të personelit dhe ndihmës internacionale, për të gjithë kohëzgjatjen e fazës së shpëtimit.

### **3 Qeveritë duhet të ndihmojnë për shpërndarjen në kohë të mallrave të shpëtimit dhe të informacionit gjatë fatkeqësisë**

Furnizimet dhe pajisjet për shpëtim sillen në një vend për qëllimin e vetëm që të zbusin vuajtjen njerëzore, dhe jo për përfitime komerciale. Këto furnizime normalisht duhet të jepen falas dhe të lehtësohen nga doganat, dhe nuk duhet të jenë subjekte të kërkesave për certifikata përfaqësuese mbi origjinën, ose faturat, licencat e importit dhe/ose eksportit ose kufizime të tjera, ose të taksës së importit, taksës së mbërritjes ose detyrimeve të portit.

Importimi i përkohshëm i pajisjeve të nevojshme për shpëtim, duke përfshirë mjettet e transportit, avionet e lehtë dhe pajisjet e telekomunikacionit, duhet të lehtësohet nga qeveria pritëse, përmes sigurimit të përkohshëm të licencave ose kufizimeve për regjistrim. Në mënyrë të barabartë, qeveritë nuk duhet të kufizojnë riekportimin e pajisjeve të shpëtimit në fund të operacionit.

Për të lehtësuar komunikimin, qeveritë pritëse inkurajohen që të përhapin frekuenca të caktuara të radiove, të cilat mund të përdoren nga organizatat e shpëtimit brenda vendit ose për komunikim ndërkombëtar dhe për t'i bërë këto frekuenca të njohura në komunitetin që reagon ndaj fatkeqësisë. Ata duhet të autorizojnë personelin e shpëtimit që të përdorin të gjitha mjettet e komunikacionit të kërkuara për operacionet e tyre të shpëtimit.

### **4 Qeveritë duhet të sigurojnë informacione rreth situatës së fatkeqësisë, si dhe shërbim planifikimi të koordinuar**

I gjithë planifikimi dhe koordinimi i përpjekjeve për shpëtim është në mënyrë përfundimtare përgjegjësia e qeverive pritëse. Planifikimi dhe koordinimi mund të përmirësohen shumë në goftë se AHJQ-të pajisen me informacion mbi nevojat për shpëtim dhe me sistemet qeveritare për planifikim dhe zbatim të përpjekjeve për shpëtim, si edhe me informacionin mbi reziqet e sigurisë me të cilat ata mund të përballen. Qeveritë nxiten që të sigurojnë një informacion të tillë për AHJQ-të. Për të ndihmuar koordinimin efektiv dhe përdorimin eficient të përpjekjeve për shpëtim, qeverive pritëse u rekomandohet të

seleksionojnë, para fatkeqësisë, një pikë kontakti për AHJQ-të e brendshme për të komunikuar me autoritetet nacionale.

### **5 Shpëtimi nga fatkeqësia në rastin e konfliktit të armatosur**

Në rastin e konfliktit të armatosur, veprimet për shpëtim janë të drejtuara nga kushtet përkatëse të ligjit ndërkombëtar humanitar.

## **Aneksi II: Rekomandimet për qeveritë donatore**

### **1 Qeveritë donatore duhet të njohin dhe respektojnë pavarësinë, veprimet humanitare dhe të paanshme të AHJQ-ve**

AHJQ-të janë organizma të pavarur, pavarësia dhe paanshmëria e të cilave duhet të respektohen nga qeveritë donatore. Qeveritë donatore nuk duhet t'i përdorin AHJQ-të për qëllime të mëtejshme politike ose ideologjike.

### **2 Qeveritë donatore duhet të sigurojnë financim me një garanci të pavarësisë operative**

AHJQ-të pranojnë fonde dhe ndihmë materiale nga qeveritë donatore pasi ato e shpërndajnë atë tek viktimat e fatkeqësisë; kjo përbën një veprim humanitar dhe pavarësi veprimi. Zbatimi i aksioneve të shpëtimit është plotësisht përgjegjësi e AHJQ-të dhe do të kryhet sipas politikave të AHJQ-ve.

### **3 Qeveritë donatore duhet të përdorin zyrat e tyre për të ndihmuar AHJQ-të në mundësinë e njohjes së viktimave të fatkeqësisë**

Qeveritë donatore duhet të njohin rëndësinë e pranimit të një niveli të përgjegjësisë për sigurinë dhe lirinë e mundësisë së personelit të AHJQ-ve të hyjnë në vendndodhjen e fatkeqësisë. Ato duhet të përgatiten të ushtrojnë diplomaci me qeveritë pritëse rreth problemeve të tilla, nëse është e nevojshme.

## **Aneks III: Rekomandimet për organizatat ndërqeveritare**

### **1 ONQ- të duhet të njohin AHJQ-të, lokale dhe të huaja, si partnerë të vlefshëm**

AHJQ-të kanë vullnetin të punojnë me agjencitë e KB (Kombeve të Bashkuara) dhe me agjenci të tjera ndërqeveritare me qëllim që të ndikojnë më mirë në reagimin ndaj fatkeqësisë. Ata veprojnë kështu sipas ndjenjës së partneritetit (bashkëpunimit) i cili respekton integritetin dhe pavarësinë e të gjithë partnerëve. Agjencitë ndërqeveritare duhet të respektojnë pavarësinë dhe paanshmerinë e AHJQ-ve. AHJQ-të duhet të konsultohen me agjencitë e Kombeve të Bashkuara rreth përgatitjeve të planeve të shpëtimit.

### **2 ONQ-të duhet të ndihmojnë qeveritë pritëse në sigurimin e një platforme gjithëpërfshirëse koordinimi për shpëtimin ndërkombëtar dhe lokal nga fatkeqësia**

ONQ-të, zakonisht nuk e kanë mandatin për sigurimin e një platforme të plotë të koordinimit për fatkeqësitë, të cilat kërkojnë një reagim ndërkombëtar. Kjo përgjegjësi bie mbi qeveritë pritëse dhe autoritetet përkatëse të Kombeve të Bashkuara. Ato nxiten që të sigurojnë këtë shërbim në kohë dhe në një mënyrë efektive për t'i shërbyer shtetit të prekur dhe komunitetit kombëtar dhe ndërkombëtar. Në çdo rast, AHJQ-të duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar koordinimin me efikasitet të shërbimeve të tyre.

Në rastin e konfliktit të armatosur, veprimet e shpëtimit ndaj fatkeqësisë drejtohen nga kushtet përkatëse të ligjit ndërkombëtar humanitar.

### **3 ONQ-të duhet të zgjerojnë mbrojtjen e sigurisë për organizatat e Kombeve të Bashkuara, të AHJQ-ve**

Atje ku shërbimet e sigurimit sigurohen nga organizatat ndërqeveritare, ky shërbim duhet të zgjerohet për partnerët e tyre operues të AHJQ-të

ku kërkohet.

### **4 ONQ-të duhet t'u sigurojnë AHJQ-ve të njëjtën mundësi të marrjes së informacionit ashtu siç u garantohet organizatave të Kombeve të Bashkuara**

ONQ-të nxiten që të ndajnë të gjithë informacionin që i përket implementimit me efikasitet të përgjigjes ndaj fatkeqësisë, me partnerët e tyre operues të AHJQ-ve.